



UNIVERSITETI • UNIVERSITY  
"KADRI ZEKA"



## MARËVESHJE BASHKËPUNIMI

*ndërmjet:*

Kjo MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ("MB") është lidhur në mes të Universitetit "Kadri Zeka" (në tekstin e mëtejmë: Universiteti), i cili gjendet në Gjilan adresë: "Zijah Shemsiu". Përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor dhe **PEMA - Qendra e Kujdesit Ditor** (në tekstin e mëtejmë: Qendra) e cila gjendet edhe në Gjilan, adresë "7 Shtatori nr. 2" përfaqësuar nga znj. Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive.

Universiteti ka studentë të regjistruar në studime të larta relevante, arsimimi i të cilëve do të zhvillohet nga përvoja praktike arsimore dhe dëshira për të shfrytëzuar resurset që ofron Qendra për studentët e Universitetit, ndërsa Qendra ka resurse adekuate dhe shpreh dëshirë për t'i bërë ato të disponueshme për qëllime të zhvillimit arsimor dhe përvojës për studentet e Universitetit. Qendra ofron shërbime psikosociale dhe rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara nga 3 – 18 vjeç.

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi profesional në praktikën e studentëve të Fakultetit të Edukimit dhe Fakultetit te Shkencave Kompjuterike në kujdesin dhe mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

### I. Kushtet e përgjithshme

- Qendra dhe Universiteti, sipas nevojës dhe pajtimit nga dy palët, do të bashkëpunojnë në përzgjedhjen e studentëve për kryerjen e praktikës tek Qendra.
- Para datës së fillimit, Qendra do ti prezantoj Universitetit informata me përshkrim dhe aranzhimet e punës, përfshirë, mes tjerash, pritet që ka Qendra, dhe përgjegjësitë e studentit/praktikantit.
- Asnjëra palë nuk do të diskriminoj personat të përfshirë në këtë MB dhe që rrjedhin nga i njëjtë për shkak të racës, gjinisë, moshës, fesë, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike dhe kombëtarë.
- Palët pajtohen se nuk do të ketë obligime financiare nga cilado palë ndaj tjetrës dhe se pranimi i studenteve për praktikë tek Qendra nuk obligon atë të kompensoj Universitetin apo anasjelltas. Çfarëdo lloj marrëveshje të kompensimit financiar, në rast se do te ekzistonte, do të bëhet në mënyrë të veçantë dhe nuk është pjesë e këtij MB.
- Kur kushtet lejojnë tërheqjen apo largimin e studentit nga praktika, palët do të

diskutojnë për të përcaktuar masat e përshtatshme për ti ndërmarrë të cilat janë në interes më të mirë të studentit dhe të palëve, e veçanërisht përfituesve të drejtpërdrejtë të Qendrës. Të dy palët rezervojnë të drejtën për të térhequr/larguar studentin nga praktika nëse Universiteti nuk është në gjendje ti përbahet kushteve të këtij MB apo studenti shkel politikat, rregullat dhe rregulloret themelore të Qendrës të cilat i janë përcjellë studentit.

- Asnjëra palë nuk do të shfrytëzoj emrin apo autoritetin e tjetrës për çfarëdo publikimi apo çështje tjera, pa aprovimin paraprak me shkrim nga pala tjetër.
- Interesimi/kërkesa e Qendrës për qasje në të dhëna të caktuara nga dosjet e studentëve përkatës nuk do të trajtohet plotësisht e kufizuar dhe do të lejohet veçanërisht për çështje verifikimi, vlerësimi dhe të përzgjedhjes.
- Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike do të ndihmojnë në hulumtime, me programe të ndryshme dhe zhvillimin e platformave, të cilat mund të përdoren nga Qendra.
- Studentët nga Fakulteti i Edukimit do të mësojnë, do të udhëzohen se si të ofrojnë kujdes dhe mbështetje, përmes programeve psikosociale, për fëmijët me aftësi të kufizuara, që në të ardhmen të janë më të përgatitur për të punuar me Planet Individuale të Arsimit (IEP) në institucionet parashkollore dhe në shkolla dhe për të marrë përgjegjësinë për zbatimin e tyre.
- Gjithashtu, palët janë pajtuar që të bëjnë edhe shkëmbimin ndërinstitucional të kuadrove duke ftuar stafin e institucionit/organizatës partnere të merr pjesë në aktivitete të ndryshme hulumtuese dhe zhvillime profesionale me qëllim përforcimi të programeve studimore në të ardhmen.

## **II. Përgjegjësit e Universitetit**

- Universiteti do të caktoj një person përkatës i cili do të bashkëpunoj me Qendrën për të ndihmuar në përzgjedhjen dhe vlerësimin e studentëve për angazhim në praktikë.
- Universiteti është përgjegjës kryesorë për vlerësimin arsimor/akademik përfundimtar të studentëve për ti përbushur kërkeshat e Qendrës.
- Pasi që shërbimet e ofruara në Qendër kërkojnë angazhim diskrecional i cili është mjaft i vlefshëm për politikat e Qendrës, Universiteti dhe studenti duhet të janë të pajtimit të mbajnë të gjitha të dhënat lidhur me punën/praktikën në Qendër plotësisht konfidenciale gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij MB si dhe pas përfundimit të tij.
- Universiteti do të kërkoj nga studentet që të pajtohen ti përcjellin me përpikëri politikat, rregullat dhe rregulloret e Qendrës gjatë praktikës. Modaliteti i përzgjedhjes do të vendoset nga dekanatet e Fakulteteve të lartëcekura.

## **III. Përgjegjësítë e Qendrës.**

- Qendra do të përcaktoj/angazhoj një punonjës, me kualifikim adekuat, të bashkëpunoj në zhvillimin e detyrate për studentët dhe aktivitete trajnuese/praktikuese dhe të drejtoj, vlerësoj dhe mbikëqyrë përfomancën e studentit gjatë praktikës. Qendra është përgjegjëse për mbikëqyrjen e drejtpërdrejt dhe udhëzimin e aktiviteteve të studentit/praktikantit gjatë aktiviteteve në Qendër apo kudo që Qendra zhvillon aktivitete.
- Qendra pajtohet ti aranzhoj oraret e vijimit të praktikës në Qendër në mënyrë që mos

të gërshetohen me ato të vijimit akademik të studentit në Universitet.

- Qendra do ti ofroj studentëve resurse të mjaftueshme për të mundësuar të funksionoj me efektivitet dhe ti përm bush objektivat e praktikës.
- Në fillim të se cilës praktikë, Qendra pajtohet ti ofroj secilit student të tij të përzgjedhur që të vijoj praktikën, të gjitha rregulloret dhe politikat të disponueshme në fuqi e të cilat studenti/praktikanti pritet ti përbahet gjatë angazhimit në praktikë pran shërbimeve të Qendrës me përpikëri. Kjo kërkesë përfshinë, mes tjera sh, procedura që nevojiten për të ruajtur informata konfidenciale, në rast se të tilla përfshihen në praktikën e praktikantit.
- Në rast se Qendrës i shfaqet ndonjë material apo shqetësim lidhur me përformancen e studentit apo në rast se rrëthanat specifike shfaqen e të cilat sjellin Qendrën në konkluzion se studenti përkatës do duhet të tërhoqet nga praktika para skadimit të afatit të dakorduar paraprak, Qendra menjëherë do të komunikoj më personin përkatës bashkëpunues të Universitetit për ta zgjidhur çështjen e tillë bashkërisht, dhe rezervon të drejtën që në vazhdim ta largoj studentin nga praktika, në rast se shihet e domosdoshme nga Qendra.
- Qendra do të përpiloj një marrëveshje të veçantë për studentin/praktikantin, e cila përfshinë të drejtat, detyrimet dhe kërkesat të përcjellën me përpikëri nga ana e studentit/praktikantit gjatë periudhës së praktikës, e që janë në përputhje me këtë MB.

#### **IV. Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit**

- Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë për ndryshimet dhe plotësimet e tij si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve.
- Ndryshimet ose plotësimet e marrëveshjes do të janë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre.
- Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë program të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të janë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

#### **V. Kohëzgjatja dhe efektit juridike**

- Kjo Marrëveshje lidhet me kohëzgjatje prej 3 viteve. Përfundimi i këtij bashkëpunimi mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.
- Kjo Marrëveshje mund të përfundoj njëanshëm nga cila do pale me paralajmërim prej së paku prej 1 (një) muaji.

#### **VI. Ligji i aplikueshëm**

- Palët respektojnë dhe zbatojnë ligjet në fuqi të shtetit, rregullat dhe kërkesat tjera të aplikueshme të autoriteteve përkatëse shtetërore.


## VII. Mospajtimet

- Palët pajtohen që çfarëdo shqetësimi apo mosmarrëveshje eventuale nga ky MB ta zgjidhin në mënyrë miqësore. Në rast të dështimit të arritjes së një marrëveshje të tillë, palët pranojnë kompetencën e gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

## VII. Hyrja në fuqi

- Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit. Bashkëpunimi nënshkruhet në dy kopje, për secilën pale nga një.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 14/12/2018.

PËR: UNIVERSITETIN “KADRI ZEKA”		PËR: OJQ “QENDRA E KUJDESIT DITOR - PEMA”	
Emri:	Z. Bajram Kosumi	Emri:	Znj. Liridona Zogaj
Pozita:	Rektor	Pozita:	Drejtoreshë Ekzekutive
Nënshkrimi/Vula:		Nënshkrimi/Vula:	